

<b>RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	
<b>EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7703/1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
<b>MINISTRIA UDHËHEQËSE</b>	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
<b>FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	Finale
<b>BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	I brendshëm
<b>DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së</b>	Jo e zbatueshme
<b>PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA</b>	Nuk ka
<b>DATA E KONSULTIMIT PUBLIK</b>	Hedhur për konsultim në datë 3.4.2023 dhe përfunduar në datë 3.5.2023. <a href="https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/622">https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/622</a>
<b>DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	20/06/2023
<b>A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT</b>	Po 04/11/2022
<b>NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	2023– MFE – Nr. VN: 5
<b>TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)</b>	Amela Kora <a href="mailto:Amela.Kora@financa.gov.al">Amela.Kora@financa.gov.al</a> Silvia Qesku <a href="mailto:Silvia.Qesku@financa.gov.al">Silvia.Qesku@financa.gov.al</a>
<b>PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)</b>	
<b>PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT</b>	
<i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)</i>	
<p>Natyra e problemit ka karakter legjislativ që lidhet me vakumin apo dhe me përmirësimin e Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fushën e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme shoqërore.</p> <p>Problematikat e hasura në kuadrin rregullator të kësaj fushe, si më poshtë vijon:</p> <p>Problematikat e hasura në kuadrin rregullator të kësaj fushe, si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e një mekanizmi lehtësues për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore për personat e punësuar në fushën e teknologjisë së informacionit (IT) sipas</li> </ul>	

**Ligjit Nr. 58/2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Parqeve Teknologjike dhe Shkencore”;**

Aktualisht mungon një mekanizëm i tillë që përjashton derdhjen e kontributeve shoqërore sipas skemës aktuale dhe që mundëson derdhjen e kontributeve duke marrë si bazë pagën minimale në shkallë vendi, vetëm për këtë kategori të punësuarish.

**- Vazhdimi i pagesës së kontributeve nga një kategori përfituesish të pensionit të pleqërisë;**

Kjo problematikë konsiston pikërisht në pagesën e panevojshme të kontributeve nga pensionistët e vetëpunësuar si të vetëm në sektorin privat, kur ata kanë plotësuar tashmë kushtet për përfitimin e pensionit të pleqërisë dhe të cilët aktualisht tërheqin kështu koston mujor të pensionit, pasi atyre nuk u njihet koha e vetëpunësimit si periudhë sigurimi.

**- Mos përditësimi i ligjit aktual me ndryshimet dixhitale të kohës ku tashmë shërbimi që prek sigurimet shoqërore ofrohet në rrugë elektronike (online);**

Mungesa e harmonizimit të Ligjit Nr. 7703/1993 me aktet e tjera ligjore, siç është Ligji Nr.107/2021 “Për bashkëqeverisjen” si dhe VKM Nr. 252, datë 29.4.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre” të cilat janë përditësuar me ndryshimet e fundit të ofrimit të shërbimeve. Kjo problematikë vazhdon të sjellë barrë administrative të shtuar për qytetarët.

**- Mungesa e një mekanizmi ligjor ka çuar në pamundësi të kthimit të pagesave të bllokuara, në llogarinë e pensionistit që jeton jashtë vendit, por që nuk mund të kthehen në llogaritë e fondit me kërkesë zyrtare të organeve të Sigurimeve Shoqërore.**

Pasojat e problemeve të lartpërmendura shtrihen në nivel kombëtar dhe ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për të garantuar zgjidhjen e problematikave aktuale të konstatuara.

**OBJEKTIVAT**

*Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?*

*Objektivat kryesorë që synohen të arrihen nëpërmjet miratimit të kësaj politike janë:*

1. Krijimi i lehtësirave për një kategori personash me profesion në fushën e teknologjisë së informacionit, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në një fushë specifike sikurse janë Tekno-Parqet, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi me elemente të sigurimeve shoqërore nxit punësimin dhe investimet;
2. Përjashtimin, brenda vitit 2024, nga barra e pagesës së kontributeve të një kategorie përfituesish të pensionit të pleqërisë që vetëpunësohen si të vetëm në sektorin privat;
3. Garantimin e harmonizimit të kuadrit ligjor të zbatueshëm në këtë fushë brenda vitit 2024.
4. Shmangien e barrës administrative nëpërmjet dixhitalizimit të procesit të aplikimeve për përfitimin e pensioneve të pleqërisë;
5. Garantimi i rikuperimit brenda vitit 2024, të 80% të kësteve të pensioneve të derdhura tepër në llogarinë e pensionistit pas vdekjes.

**OPSIONET E POLITIKAVE**

*Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.*

#### *OPSIONI 0 (status quo-ja)*

Avantazh: Nuk ka efekte financiare për qeverinë.

Dizavantazh: Mosndërhyrja e qeverisë nëpërmjet një politikë të caktuar do të bënte të pamundur arritjen e objektivave.

Ky opsion nënkupton mosndërmarrjen e një nisme në fushën e sigurimeve shoqërore. Mosndërhyrja e qeverisë nëpërmjet një mekanizmi rregullator apo jo rregullator, për të ndryshuar/modifikuar qasjen e ndjekur deri më tani, shoqërohet me avantazhet dhe disavantazhet e saj.

Ndër avantazhet mund të rendisim mosekzistencën e efekteve financiare negative, direkte, për buxhetin e shtetit. Nëse zgjidhet ky opsion, nuk do të krijohet një grup pune përgjegjës për të përgatitur nismën rregullatore apo për të konceptuar ndërhyrjen jo rregullatore. Njëkohësisht shteti do të mund të “ruajë” të ardhurat që aktualisht mbledh në kuadër të pagesës së kontributeve shoqërore nga pensionistët e vetëpunësuar si të vetëm.

Megjithatë, nëse zgjidhet opsioni 0, disavantazhet ekonomike, rregullatore dhe sociale, direkte apo indirekte, afatshkurtra, apo me afatgjata, do të tejkalojnë avantazhet e këtij opsioni.

Zgjedhja e opsionit të status quo-së nënkupton më konkretisht:

- Moszgjidhjen e problemit që buron nga ekzistenca e një kuadri rregullator të paharmonizuar;
- Moskrijimin e lehtësirave fiskale për zhvilluesit, përdoruesit dhe të punësuarit IT në parqet teknologjike/shkencore, në kuadër të ligjit përkatës. Kjo do të shoqërohet me efekte negative ekonomike në afatgjata për shkak të mos thithjes së investimeve në këtë fushë dhe moszhvillimit të këtyre parqeve sikurse është qëllimi i ligjit;
- Moszgjidhjen e problemit të pagesës së kontributeve shoqërore dhe për pensionistët që kanë ndërruar jetë.
- Vijimin e burokracive administrative për procedurat e aplikimit për marrjen e pensioneve, në mospërputhje me politikën e dixhitalizimit të proceseve administrative.

Për arsyet e lartpërmendura, gjykojmë se opsioni 0 nuk mund të zgjidhet si opsion i preferuar dhe duhet të vijohet me marrjen në konsideratë të opsioneve të tjera rregullatore.

#### *Opsioni 1 (i preferuar):*

Hartimi dhe miratimi i një projektligji për ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”

Ligji aktual rregullon dhe trajton efektivisht pjesën më të madhe të çështjeve që lidhen me sigurimet shoqërore, megjithatë Ministria e Financave dhe Ekonomisë së bashku me Institutin e Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet këtij projektligji kërkon të trajtojë/zgjidhë problematikat e hasura në punën e përditshme. Ky opsion siguron realizimin e objektivave në një kohë më të shkurtër, pasi ndryshimet e propozuara prekin 9 nene nga 100 nene të ligjit aktual dhe për këtë arsye, në kuadër të teknikës legjislative, vlerësohet më e arsyeshme ndërhyrja nëpërmjet një ligji ndryshues dhe jo hartimit të një ligji të ri. Gjithashtu, nëpërmjet këtij opsioni adresohen në mënyrë shteruese problematikat e hasura në përditshmëri dhe të evidentuara në rubrikën përkatëse;

Në lidhje me analizën e kostove dhe përfitimeve që parashikohet të sjellë ky projektligj, kemi vlerësuar si metodë më të përshtatshme për të analizuar opsionet metodën e analizës me shumë

kritere. Kuantifikimi i kostove dhe përfitimeve nga ndryshimet e parashikuara në këtë projektligj në vlerë monetare rezulton i pjesshëm dhe i vështirë për t'u bërë.

**Ndryshimi i ligjit ekzistues Nr. 7703/1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, është vlerësuar me më shumë pikë, për këtë arsye është përzgjedhur si opsion i preferuar.**

Megjithatë sqaroj se: Efektet financiare për lehtësirat që do të përfitojnë personat e punësuar në fushën e teknologjisë së informacionit (IT) që janë të regjistruar në subjektet me aktivitet kryesor në fushën e teknologjisë së informacionit, të cilët do të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore në nivelin e pagës minimale mujore në shkallë vendi, pavarësisht pagës bruto të deklaruar nuk është i matshëm sepse maturimi i saj është afatgjatë.

Efektet financiare për nismën e Këshillimit Kombëtar është: Aktualisht janë 1 484 përfitues të pensionit të pleqërisë të vetëpunësuar të vetëm në sektorin privat të cilët paguajnë kontribute çdo muaj në masën 14,151,424 lekë, të cilat kalojnë në fondin e sigurimeve shoqërore. Shuma 169,817,088 lekë në vit me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve do të zbritet nga të ardhurat në fondin e sigurimeve shoqërore.

*Opsioni 2: “Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri”*

Përderisa ligji ekzistues është i vitit 1993 dhe ka pësuar ndryshime ndër vite, është marrë në konsideratë edhe opsioni i miratimit të një ligji të ri që do të mund të konsolidonte legjislacionin dhe do të bënte të mundur realizimin e objektivave. Megjithatë, nisur dhe nga konteksti aktual, nevoja e ndërhyrjes në një kohë sa më të shkurtër dhe faktit që ndryshimet nuk prekim më shumë se 50% të dispozitave të ligjit në fuqi, është vendosur të mos zgjidhet si i preferuar ky opsion pasi kërkon më shumë kohë dhe resurse (njerëzore dhe financiare) për tu zbatuar.

## **ANALIZA E NDIKIMEVE**

*Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.*

Grupet e prekura nga opsioni i preferuar janë:

1. Qeveria;
2. Zhvilluesit, përdoruesit e parqeve teknologjike/shkencore;
3. Punonjësit IT, të punësuar në parqet teknologjike/shkencore, sipas ligjit 58/2022;
4. Pensionistët e vetëpunësuar, si të vetëm;
5. Familjarët/trashëgimtarët e pensionistëve që kanë ndërruar jetë;
6. Qytetarët.

### **Ndikimet ekonomike:**

- **Direkte**
  - **Pozitive**

*Për qeverinë (Buxhetin e Shtetit):*

Zbatimi i opsionit të preferuar do të mundësonte rikuperimin brenda një kohe sa më të shkurtër të pagesave të pensioneve të hedhura tepër (pas kohës së vdekjes), për pensionistët që kanë ndërruar jetë. Aktualisht ky problem është evidentuar kryesisht për pensionistët që jetojnë jashtë vendit, por

shumat gjithsesi janë të konsiderueshme dhe me zbatimin e këtij opsioni synohet rikuperimi dhe rikthimi në fondin e sigurimeve shoqërore të 80% të fondeve të bllokuara.

*Për zhvilluesit, përdoruesit e parqeve teknologjike/shkencore:*

Zbatimi i opsionit të preferuar ka një efekt të pritshëm pozitiv tek zhvilluesit dhe përdoruesit e parqeve teknologjike/shkencore, duke qenë se politika mundëson një mekanizëm lehtësues për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore për personat e punësuar në fushën e teknologjisë së informacionit (IT) sipas Ligjit Nr. 58/2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Parqeve Teknologjike dhe Shkencore”.

#### **ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR**

*Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)*

Opsioni i preferuar është përzgjedhur opsioni 1: “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Opsioni i preferuar është përzgjedhur opsioni 1 - kryerja e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 ‘Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar’, pasi nëpërmjet këtij opsioni mund të sigurohet zhvillimi i mëtejshëm i aktivitetit të parqeve teknologjike/shkencore që zhvillojnë aktivitetin sipas Ligjit Nr. 58/2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Parqeve Teknologjike dhe Shkencore”, realizmi i objektivave të vendosura në një kohë më të shkurtër, pasi ndryshimet e propozuara prekin vetëm 9 nene nga 100 nene të ligjit aktual dhe në kuadër të teknikës legjislative, nuk vlerësohet si i arsyeshëm hartimi i një ligji i ri.

- Adreson në mënyrë shteruese problematikat e hasura në përditshmëri;
- Harmonizon ligjin aktual me legjislacionin në fuqi për ofrimin e shërbimeve elektronike (Ligji Nr.107/2021 “Për bashkëqeverisjen” si dhe VKM Nr. 252, datë 29.4.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”).

Për të dhënë një ide më të qartë të arsyeve së përzgjedhjes së Opsionit 1 si opsioni i preferuar për implementimin e politikës, është përgatitur analiza multikritere. Nëpërmjet kësaj analize rezulton se opsioni i preferuar është opsioni 1 i cila ka dhe numrin më të lartë të pikëve me 75 krahasuar me opsionin 2 dhe opsionin 0.

*Për pensionistët e vetëpunësuar, si të vetëm:*

Kjo politikë do të impaktojë pozitivisht të gjithë pensionistët e punësuar si të vetëm në sektorin privat, duke qenë se do të përjashtohen nga detyrimi për pagimin e kontributeve shoqërore në vijim, pasi ata kanë plotësuar tashmë kushtet për përfitimin e pensionit të pleqërisë.

*Për punonjësit IT, të punësuar në parqet teknologjike/shkencore, sipas ligjit 58/2022:*

Zbatimi i opsionit të preferuar ka një efekt të pritshëm pozitiv tek punonjësit IT, të punësuar në parqet teknologjike/shkencore, duke qenë se politika mundëson një mekanizëm lehtësues për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore për personat e punësuar në fushën e teknologjisë së informacionit (IT) sipas Ligjit Nr. 58/2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Parqeve Teknologjike dhe Shkencore”.

*Për qytetarët:*

*Duke qenë se, aktualisht ofrohen 56 shërbimeve online dhe harmonizimi i ligjit aktual do të mundësojë vijimin e dixhitalizimit të këtyre shërbimeve, kjo do të ketë një impakt pozitiv për qytetarët duke qenë se mundëson:*

Ulje të barrës administrative;

Ulja të kostove për disponimin e një dokumenti administrativ;

Reduktimin e kohës për disponimin e dokumentit administrativ

- **Direkte**

- **Negative**

Ndryshimet e politikës lidhur me vendosjen e pagës minimale si bazë për pagesën e kontributeve nga punonjësit IT, të punësuar në parqet teknologjike/shkencore, sipas ligjit 58/2022, si dhe përjashtimi nga pagesa e kontributeve të pensionistëve të vetëpunësuar të vetëm sjellë reduktim të të ardhurave në fondin e sigurimeve shoqërore, në buxhetin e shtetit.

**Ndikimet sociale:**

- **Direkte**

**Pozitive**

*Për qytetarët:*

*Sa i takon ndikimeve sociale që zbatimi i opsionit 1 pritet të ketë, mund të rendisim:*

- Rritja e besimit të qytetarëve kundrejt qeverisjes elektronike;
- Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve dhe kryesisht pensionistëve;
- Ulja e barrës administrative nëpërmjet ofrimit të shërbimeve elektronike 24 orë në 7 ditë të javës;
- Reduktimi i kohës për disponimin e dokumentit administrativ;
- Shtimi dhe përmirësimi i shërbimeve elektronike për publikun;
- Trajtimi në kohë, me eficiencë dhe drejtësi të kategorive specifike duke thjeshtëzuar procedurat e përfitimeve nga ligji;
- Rritja e numrit të përdoruesve të e-shërbimeve;
- Ndhmon dhe nxit në zhvillimin e politikave të reja të punësimit.

**Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):**

<b>Viti 1</b>	<b>Viti 2</b>	<b>Viti 3</b>
0	0	0

**KONSULTIMI**

*Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)*

Ky projektligji është iniciuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe nga Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional. Ministria e Financave dhe Ekonomisë e konsultoi së brendshmi me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe me Drejtorinë e Kuadrit Rregullator. Projektligji i është nënshtruar procesit të bashkërendimit dhe është dakordësuar me Ministrinë e Drejtësisë.

Komentet e Ministrisë së Drejtësisë kanë qenë si më poshtë vijon:

## **1. Mbi ligjshmërinë e formës dhe përmbajtjes**

**1.1.** Pika 2 e nenit 1 të projektligjit, bën një trajtim të diferencuar në lidhje me kategoritë e tjera të personave të punësuar/vetëpunësuar në sektorin privat apo të punësuarve në sektorin publik. Të argumentohet në relacion në mënyrë shteruese arsyeja përse po bëhet një trajtim i diferencuar ndaj këtyre personave, si dhe nëse plotësohet kriteri i nenit 18 të Kushtetutës, në mënyrë që të përlligjet një trajtim i ndryshëm nga kategoritë e tjera të të punësuarve.

**1.2.** Në lidhje me nenet 2, 3 dhe 4 të projektligjit, sjellim në vëmendje se është ndërmarrë një nismë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me këto propozime dhe aktualisht është në fazë bashkërendimi me Ministrinë e Drejtësisë, ku mendimi i fundit nga ana jonë është dhënë me shkresën nr. 6303/2 prot., datë 30.01.2023. Për rrjedhojë, në relacionin shoqërues të projektligjit të argumentohen komentet e dhëna me atë shkresë.

**1.3.** Fjalja e dytë e paragrafit të dytë të pikës 1 të nenit 5, është e panevojshme për shkak se përfaqësuesi nga ministria për çështjet financiare është i parashikuar në nënndarjen “ii” të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 5 të projektligjit.

**1.4.** Në lidhje me nenin 6 të projektligjit, aktualisht Drejtori i Përgjithshëm *“Emëron punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, drejtorët e Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, si dhe përcakton rregullat e rekrutimit të personelit për këto drejtori”*. Ndërkohë, me ndryshimet që kërkohet të bëhen përcaktohet se Drejtori i Përgjithshëm emëron punonjësit e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Në relacionin shpjegues të jepen argumente shteruese në lidhje arsyet e këtij ndryshimi, duke shpjeguar mënyrën e emërimit të këtyre punonjësve aktualisht, arsyen pse bo bëhet një zëvendësim i tillë dhe si do të bëhet mënyra e emërimit të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe drejtorëve të Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, me ndryshimet që pëson shkronja “d” e nenit 75 të Ligjit nr. 7703/1993 i ndryshuar.

**1.5.** Në lidhje me nenin 8 të projektligjit, në relacionin shpjegues të jepen argumente shterues në lidhje me ngritjen e kësaj strukture të posaçme për caktimin e pensioneve dhe arsyen pse krijohet si strukturë paralele, në kushtet kur aktualisht caktimin e bën vetëm Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

**1.6.** Parashikimi i bërë në nenin 9 të projektligjit duhet të vendoset në një nen më vete dhe jo të shtohet në nenin 87 të ligjit ekzistues. Për rrjedhojë, të parashikohet rrethi i personave që kanë detyrimin për të kthyer kështet e pensioneve të kaluar padrejtësisht në llogari.

## **2. Mbi çështjet e zbatimit të unifikuar të teknikës legjislative**

**2.1.** Në të gjithë përmbajtjen e projektligjit të mbahen në konsideratë formulat ndryshuese të përcaktuar në nenet 36 dhe 37 të udhëzimit nr. 6/2022 të Ministrit të Drejtësisë *“Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”*. Njëkohësisht në nenin 5 të projektligjit, në kushtet kur shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1, pika 2 dhe 3 nuk ndryshojnë, nuk është e nevojshme të riprodhohet i gjithë neni në tërësi, por vetëm ato pika që ndryshojnë.

## **Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka sqaruar se:**

**Për pikën 1.1:** Sipas Ligjit Nr. 7703/1993 i ndryshuar, personat e punësuar paguajnë kontribute në të gjitha degët e sigurimeve shoqërore dhe kanë të drejtë për të gjitha përfitimet e parashikuara në ligj. Kontributet e të punësuarve nën një kontratë pune ndahen ndërmjet personit të siguruar dhe punëdhënësit të tij, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe derdhen nga punëdhënësi. Personat ekonomikisht aktiv (punëdhënës dhe të vetëpunësuar) janë të detyruar të paguajnë vetëm në dy degë, barrëlindje dhe pensione.

Po kështu, në shkronjën d, të pikës 1, të kreut I të VKM Nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” përcaktohet se: *“Të vetëpunësuarit me statusin e personit fizik, që ushtrojnë veprimtari ekonomike, sigurohen në mënyrë të detyrueshme, jo më pak se niveli minimal, për degën e barrëlindjes, pensioneve dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor.”*

Duke qenë se i punësuarit kontribuon në të gjitha degët e sigurimeve shoqërore dhe kontributet paguhen midis tij dhe punëdhënësit, përjashtimi nga pagimi i kontributeve pensionistëve të punësuar në sektorin privat do të deformonte tregu e punës, dëmtonte skemën e sigurimeve shoqërore dhe do të sillte problematika lidhur me administrimin fiskal. Punëdhënësit do të ishin të prirur të punësonin pensionistë, ndërkohë që përjashtimi i pensionistëve të vetëpunësuar me statusin e personit fizik në sektorin privat nuk do të përbënte një problem, përveç pakësimit të të ardhurave në degën e sigurimeve shoqërore të barrëlindjes dhe të pensioneve, për të cilat kjo kategori paguan kontribute dhe pagesa në këto dy degë të sigurimit nuk u garanton një mbrojtje të shtuar.

Për këtë arsye, nëpërmjet këtij projektligji do të mundësohet lehtësimi nga barra e pagesës së kontributeve vetëm të pensionistëve të pleqërisë që vetëpunësohen si të vetëm në sektorin privat.

Të vetëpunësuarit pensionista përgjithësisht janë në fushën e shërbimeve dhe zanateve të cilët për shkak të moshës punojnë me orar të reduktuar dhe të ardhurat që ata nxjerrin janë relativisht të ulëta duke mos garantuar një pagë të plotë si në rastin e pensionistëve të punësuar.

**Për pikën 1.2:** Sqarojmë se ka patur një nismë të mëparshme, ku nëpërmjet shkresës nr. 6303/2 prot., datë 30.01.2023 të Ministrisë së Drejtësisë kanë ardhur komentet e mëposhtme:

*Ministria e Drejtësisë vlerëson se, në drejtim të teknikës legjislative, dispozita nuk është vendosur në pjesën e duhur, sa kohë neni 9 ka rregulluar llojet e kontributeve për t’u paguar, ndërkohë që dispozita e propozuar shton një përjashtim pas nenit 9, duke u bazuar tek lloji i subjektit që përjashtohet për të paguar kontributin. Për këtë qëllim, sugjerohet që pika 1 e dispozitës, të vendoset pas nenit 15 duke u riformuluar si vijon: “Përjashtohen nga detyrimi për të paguar kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, përfituesit e pensionit të pleqërisë që vetëpunësohen në sektorin privat”.*

*Gjithashtu, sugjerohet që pika 2 e dispozitës të shtohet pas nenit 58, ndërkohë që pika 3, sipas sugjerimit të mëparshëm të Ministrisë së Drejtësisë, në nenin 57.*

*Së fundmi, Ministria e Drejtësisë i qëndron mendimit mbi nevojën për të arsyetuar kriteret e nenit 18 të kushtetutës, për trajtimin e diferencuar që i bëhet të punësuarve në sektorin publik.*

Në këtë projektligj komentet e Ministrisë së Drejtësisë janë reflektuar.

**Për pikën 1.3:** Komenti është pranuar dhe reflektuar në projektligj.



**Për pikën 1.4:** Në nenin 6 është përcaktuar që punonjësit e sistemit të sigurimeve shoqërore emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm sipas përcaktimeve ligjore. Aktualisht, personeli i sigurimeve shoqërore emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm pas procedurës së konkurrimit të miratuar në rregulloren e personelit të ISSH bazuar në vendimet e KA që emërimi i punonjësve kryhet nga Drejtori i Përgjithshëm. Ky përcaktim në ligj sanksionon këtë praktikë dhe vendimmarrjen e KA.

**Për pikën 1.5:** Në nenin 8, është përcaktuar që pensionet përcaktohen në drejtoritë rajonale ose në një njësi qendrore. Aktualisht, pensionet caktohen pranë drejtorive rajonale të cilat janë në çdo qark. Informatizimi i sistemit të sigurimeve shoqërore, aplikimi online për të gjitha shërbimet që ofron sistemi krijojnë mundësinë që caktimi i pensioneve të mund të qendërzohet me qëllim unifikimin e praktikave administrative të pensioneve, rritjen e efektivitetit dhe eficensës, optimizimi i ngarkesës për personelin përpunues të pensioneve, uljen e kostove të auditimit dhe kontroll më i plotë i ligjshmërisë së caktimit të pensioneve dhe kontrollit të pagesave.

Gjithashtu, në këtë projektligj parashikohet që në mënyrë graduale, ISSH të përqendrojë llogaritjet dhe caktimin e pensioneve në një njësi qendrore, duke reduktuar gradualisht veprimtarinë e drejtorive rajonale. Kjo është një eksperiencë që zbatohet në të gjithë vendet e BE e më gjerë dhe tashmë edhe në Shqipëri, pas grumbullimit të materialit arkivor, janë krijuar mundësitë për ndërmarrjen e masave të tilla. Caktimi dhe llogaritja e pensioneve në një qendër të vetme ka disa avantazhe në administrim, cilësi, kontrollin e afateve si dhe zbatimin unik të ligjit.

**Për pikën 1.6:** Komenti për ta ndarë në një nen të veçantë pranohet. Ky nen ka për qëllim dhënien e të drejtës organeve të sigurimeve shoqërore të nxjerrin titull ekzekutiv për të bërë të mundur kthimin në llogaritë e sigurimeve shoqërore të kësteve mujore të pensioneve që janë gjeneruar dhe kaluar padrejtësisht në llogarinë bankare të pensionistit.

Bazuar në legjisllacionin e sigurimeve shoqërore, ISSH gjeneron dhe xhiron pensionin mujor në llogarinë bankare dhe në degën e bankës që ka zgjedhur vetë pensionisti, për çdo muaj. Kreditimi i pensionit ka limitin deri në gjashtë muaj. Çdo 6 muaj pensionisti duhet të konfirmoj në bankë rregullshmërinë e pagesës së përfitimeve, në këtë mënyrë edhe qenien e tij në jetë. Nga praktika e përditshme kanë rezultuar raste, sidomos ndër pensionistët që janë rezidentë jashtë shtetit, se kur pensionisti ka ndërruar jetë çregjistrimi i tij në regjistrin e gjendjes civile është bërë me vonesë ndërkohë që pensioni ka vazhduar t'i kreditohet në llogarinë e tij bankare edhe pas ndarjes nga jeta. Në shumicën e rasteve, këstet e gjeneruara për pagesë, për llogari të pensionistit, nuk janë tërhequr dhe kanë mbetur në llogarinë e tij bankare, janë bllokuar për t'u bërë të pa pageshme, por nuk mund të kthehen në llogaritë e fondit me kërkesë zyrtare të organeve të Sigurimeve Shoqërore. Në këto raste, nisur nga statusi ligjor i llogarive bankare individuale, për kthimin e shumave, bankat kërkojnë një vendim gjykate.

Për zgjidhjen e kësaj problematike për këto raste, është parashikuar shtesa në nenin 87 të Ligjit Nr. 7703/1993, për nxjerrjen e një vendimi nga ana e organeve të sigurimeve shoqërore që përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga bankat.

**Për pikën 2.1:** Komenti është pranuar dhe reflektuar në projektligj.

**Projektligji u ridërgua në Ministrinë e Drejtësisë për bashkërendim, e cila u shpreh si më poshtë:**

Për projektvendimin “Për propozimin e projektligjit ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 ‘Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë’” dhe “Për

projektligjin ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 ‘Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar’”, dërguar për bashkërendim nëpërmjet sistemit e-aktet dhe shkresës nr. 8512 prot., datë 09.05.2023, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584/2003, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar, **Ministria e Drejtësisë shprehet dakord me variantin e ripunuar.**

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7703 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në datë 3.4.2023 dhe ka përfunduar në datë 3.5.2023. Linku: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/622>

Në regjistrin elektronik të konsultimit nuk pati komente për këtë projektligj dhe gjithashtu nuk u përcoll ndonjë koment, sugjerim, apo kërkesë për sqarim nëpërmjet komunikimit elektronik apo atij postar.

Gjithashtu projektligji u konsultua në Këshillin Kombëtar të Punës. Këshilli Kombëtar i Punës përbëhet nga 7 anëtarë të Qeverisë, 10 anëtarë të shoqatës së Punëdhënësve dhe 10 anëtarë nga shoqata e Punëmarrësve. Në mbledhjen e datës 20 prill 2023 të Këshillit Kombëtar të Punës nuk ka patur komente.

## **ZBATIMI DHE MONITORIMI**

*Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)*

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e opsionit të preferuar do të jenë Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të jetë struktura përgjegjëse për administrimin e sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe i politikave të pensioneve në veçanti si dhe për përmirësimin e shërbimit ndaj tyre.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit, aftësimin profesional dhe sigurimeve shoqërore, e cila mbështet funksionimin efektiv të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, do të jetë struktura përgjegjëse për monitorimin e arritjeve të treguesve pas miratimit të politikës.

MFE do të monitorojë arritjen e treguesve nëpërmjet mbledhjes dhe analizimit të raportimeve periodike të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e politikës (ISSH dhe DPT).

## **PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE**

### **Historik**

*Jepni kontekstin e politikës.*

Ligji nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), krijoi një sistem të detyrueshëm, publik dhe me mbulim universal të sigurimeve shoqërore dhe një kolonë suplementare vullnetare. Skema e sigurimeve të detyrueshme shoqërore në Shqipëri është një skemë e bazuar në parimin “Paguaj sot që të përfitosh nesër (Pay as-You go)”, në parimin e përgjegjësisë individuale për rreziqet sociale të së ardhmes, dhe në parimin e solidaritetit midis brezave, është një skemë e bazuar në parimin kontributiv ku përfitimet janë të lidhura drejtpërdrejt me kontributet. Të gjithë personat e punësuar, punëdhënës apo të vetëpunësuar janë të detyruar të paguajnë kontribute.

- Lehtësi për personat e punësuar në fushën e teknologjisë së informacionit (IT) që janë të regjistruar në subjektet me aktivitet kryesor në fushën e teknologjisë së informacionit, të cilët do të paguajnë

kontributet e sigurimeve shoqërore në nivelin e pagës minimale mujore në shkallë vendi, pavarësisht pagës bruto të deklaruar;

- Përrjashtimi nga barra e pagesës së kontributeve të një kategorie përfituesish të pensionit të pleqërisë që vetëpunësohen si të vetëm në sektorin privat, e cila ka ardhur si kërkesë e pensionistëve nëpërmjet Këshillimit Kombëtar; Në vijim të nismës së Këshillimit Kombëtar u kërkuar të jepej mendim, nëse kjo kategori duhet të përjashtohet nga pagesa e këtyre kontributeve. Nga rezultatet e kësaj nisme evidentohet fakti se 66% e qytetarëve kanë dhënë përgjigje pozitive. Të vetëpunësuarit në moshë aktive (përveç të vetëpunësuarve në bujqësi) janë përgjegjës për të paguar vlerën totale të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Megjithatë ata nuk janë të mbuluar (për rrjedhojë nuk janë përgjegjës për të paguar kontribute) për sëmundjet, aksidentet në punë dhe pagesën e papunësisë. Për këtë arsye, propozohet të përjashtohen nga pagesa e kontributeve pensionistët e vetëpunësuar si të vetëm në sektorin privat të cilët ndërkojnë që tërheqin këstin mujor të pensionit.

- Përditësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor me ndryshimet dixhitale të kohës ku tashmë shërbimi që prek sigurimet shoqërore ofrohet në rrugë elektronike (online); Që në vitin 2022 Qeveria ishte e vendosur që të gjitha shërbimet t'i ofrohen qytetarëve dhe bizneseve në një kohë më të shkurtër, më cilësore dhe pa kontakt me administratën publike dhe propozimi është thjesht përditësim i kuadrit ligjor.

- Rikthim në fondin e sigurimeve shoqërore të shumës së kësteve të pensioneve që janë gjeneruar dhe kaluar padrejtësisht në llogarinë bankare të pensionistit nëpërmjet një mekanizmi ligjor.

ISSH gjeneron dhe xhiron pensionin mujor në llogarinë bankare dhe në degën e bankës që ka zgjedhur vetë pensionisti, për çdo muaj. Kreditimi i pensionit ka limitin deri në gjashtë muaj. Çdo 6 muaj pensionisti duhet të konfirmoj në bankë rregullshmërinë e pagesës së përfitimeve, në këtë mënyrë edhe qenien e tij në jetë. Nga praktika e përditshme kanë rezultuar raste, sidomos ndër pensionistët **që janë rezidentë jashtë shtetit**, se kur pensionisti ka ndërruar jetë çregjistrimi i tij në regjistrin e gjendjes civile është bërë me vonesë ndërkojnë që pensioni ka vazhduar t'i kreditohet në llogarinë e tij bankare edhe pas ndarjes nga jeta. Në shumicën e rasteve, këstet e gjeneruara për pagesë, për llogari të pensionistit, nuk janë tërhequr dhe kanë mbetur në llogarinë e tij bankare, janë bllokuar për t'u bërë të pa pagueshme, por nuk mund të kthehen në llogaritë e fondit me kërkesë zyrtare të organeve të Sigurimeve Shoqërore.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është një institucion publik, i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohet me dispozitat e Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe ka si qëllim mbrojtjen sociale, menaxhimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe dhënien e përfitimeve. Këshilli i Ministrave miraton statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i cili normon veprimtarinë e këtij institucioni dhe marrëdhëniet ndërmjet tij dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

ISSH është e organizuar në tre nivele drejtimi: Drejtoria Qendrore, 12 Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, dy Degë të Sigurimeve Shoqërore në Sarandë dhe Tropojë për shkak të largësisë nga qendra, Drejtoria e Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore, si dhe në Agjencitë Lokale të Sigurimeve Shoqërore në nivel qyteti ose qendre banimi, relativisht të mëdha.

### **Problemi në shqyrtim**

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problematikat e hasura në kuadrin rregullator të kësaj fushe, si më poshtë vijon:

- **Mungesa e një mekanizmi lehtësues për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore për personat e punësuar në fushën e teknologjisë së informacionit (IT) sipas Ligjit Nr. 58/2022 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Parqeve Teknologjike dhe Shkencore";**

Krijimi i parqeve teknologjike dhe shkencore mbështetet në lehtësirat fiskale dhe doganore që shteti ju mundëson investitorëve të ndryshëm me qëllim zhvillimin e parqeve teknologjike dhe shkencore, duke iu vënë në dispozicion sipërfaqen ku do të ngrihet parku dhe krijimi i infrastrukturës mbështetëse deri në kufijtë e parkut e cila konsiston në krijimin e infrastrukturës ndihmëse si ujë, energji elektrike, rrjeti komunikimit, kanalizimeve dhe kullimit etj. Qëllimi i këtij ligji ka qenë zhvillimi i industrive të teknologjisë së lartë dhe inovacionit në vendin tonë, por pas gjithë kësaj pune të bërë, Qeveria ka vënë re mungesën e interesit dhe mungesën e specialistëve/profesioneleve në fushën e TI, si pasojë e mungesës së një mekanizmi lehtësues për derdhjen e kontributeve shoqërore për të tërhequr sa më shumë persona në fushën e teknologjisë së informacionit. Pra, aktualisht mungon një mekanizëm i tillë që përjashton derdhjen e kontributeve shoqërore sipas skemës aktuale dhe që mundëson derdhjen e kontributeve duke marrë si bazë pagën minimale në shkallë vendi, vetëm për këtë kategori të punësuarish.

**- Vazhdimi i pagesës së kontributeve nga një kategori përfituesish të pensionit të pleqërisë;**

Për sa më sipër, nisma e Këshillimit Kombëtar, shfaqti më hapur problematikën e ngritur nga një grup i prekur siç janë pensionistët e vetëpunësuar të vetëm, të cilët kërkuan përjashtimin nga pagesa e kontributeve.

Kjo problematikë konsiston pikërisht në pagesën e panevojshme të kontributeve nga pensionistët e vetëpunësuar si të vetëm në sektorin privat, kur ata kanë plotësuar tashmë kushtet për përfitimin e pensionit të pleqërisë dhe të cilët aktualisht tërheqin këstin mujor të pensionit, pasi atyre nuk u njihet koha e vetëpunësimit si periudhë sigurimi. Kjo problematikë prek 1 484 pensionistë të vetëpunësuar.

**- Mos përditësimi i ligjit aktual me ndryshimet dixhitale të kohës ku tashmë shërbimi që prek sigurimet shoqërore ofrohet në rrugë elektronike (online);**

Mungesa e harmonizimit të Ligjit Nr. 7703/1993 me aktet e tjera ligjore, siç është Ligji Nr.107/2021 “Për bashkëqeverisjen” si dhe VKM Nr. 252, datë 29.4.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre” të cilat janë përditësuar me ndryshimet e fundit të ofrimit të shërbimeve. Kjo problematikë vazhdon të sjellë barrë administrative të shtuar për qytetarët.

**- Mungesa e një mekanizmi ligjor ka çuar në pamundësi të kthimit të pagesave të bllokuara, në llogarinë e pensionistit që jeton jashtë vendit, por që nuk mund të kthehen në llogaritë e fondit me kërkesë zyrtare të organeve të Sigurimeve Shoqërore.**

ISSH gjeneron dhe xhiron pensionin mujor në llogarinë bankare dhe në degën e bankës që ka zgjedhur vetë pensionisti, për çdo muaj. Kreditimi i pensionit ka limitin deri në gjashtë muaj. Çdo 6 muaj pensionisti duhet të konfirmojë në bankë rregullshmërinë e pagesës së përfitimeve, në këtë mënyrë edhe qenien e tij në jetë. Nga praktika e përditshme kanë rezultuar raste, sidomos ndër pensionistët **që janë rezidentë jashtë shtetit**, se kur pensionisti ka ndërruar jetë çregjistrimi i tij në regjistrin e gjendjes civile është bërë me vonesë ndërkohë që pensioni ka vazhduar t’i kreditohet në llogarinë e tij bankare edhe pas ndarjes nga jeta. Në shumicën e rasteve, këstet e gjeneruara për pagesë, për llogari të pensionistit, nuk janë tërhequr dhe kanë mbetur në llogarinë e tij bankare, janë bllokuar për t’u bërë të pa pagueshme, por nuk mund të kthehen në llogaritë e fondit me kërkesë zyrtare të organeve të

Sigurimeve Shoqërore, pasi një mekanizëm i tillë mungon. Në këto raste, nisur nga statusi ligjor i llogarive bankare individuale, për kthimin e shumave, bankat kërkojnë një vendim gjykatë.

Pasojat e problemeve të lartpërmendura shtrihen në nivel kombëtar dhe ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për të garantuar zgjidhjen e problematikave aktuale të konstatuara.

### **Arsyeja e ndërhyrjes**

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Ka disa arsye pse po planifikohet ndërhyrja:

Nisur nga kërkesat e shpeshta të pensionistëve të vetëpunësuar si të vetëm, si dhe nga rezultati i nismës së Këshillimit Kombëtar në fillim të vitit 2022, ku 66% e të anketuarve u shpreh pro për përjashtimin nga pagesa e kontributeve shoqërore **të kësaj kategorie**, Qeveria Shqiptare vlerësoi ndërmarrjen e kësaj iniciative lehtësuese për pensionistët **e vetëpunësuar si të vetëm**. Kjo ndërhyrje është e nevojshme pasi nevojitet përshtatja me zhvillimet ekonomike të vendit, përshtatja konkrete e sistemit me zhvillimet e përgjithshme të tregut të punës, si dhe mënyrat e reja të punësimit në fushën e teknologjisë dhe informacionit duhet të garantojnë lehtësira për subjektet që ushtrojnë aktivitetet në këtë fushë.

Nëpërmjet ndërhyrjes së qeverisë synohet:

- A) krijimi i lehtësirave për një kategori personash me profesion në fushën e teknologjisë së informacionit, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në një fushë specifike sikurse janë Tekno-Parqet, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi me elemente të sigurimeve shoqërore;
- B) përjashtimi nga barra e pagesës së kontributeve të një kategorie përfituesish të pensionit të pleqërisë që vetëpunësohen si të vetëm në sektorin privat;
- C) përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor lidhur me garantimin e cilësisë së shërbimit të cilat tashmë ofrohet në rrugë elektronike (online);
- D) rikthimi në fondin e sigurimeve shoqërore të shumës së kësteve të pensioneve që janë gjeneruar dhe kaluar padrejtësisht në llogarinë bankare të pensionistit, nëpërmjet një mekanizmi ligjor.

**Puna ekzistuese që është realizuar tashmë:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Institutin e Sigurimeve Shoqërore kanë hartuar dhe miratuar VKM të cilat bënë të mundur kalimin online të 56 shërbimeve të ISSH në e-Albania të cilat kanë krijuar një tjetër qasje të ofrimit të shërbimeve publike për moshat e treta dhe për shumicën e tyre përgjigjja merret online. duke shmangur ecejaket nëpër sportele e pritjet e gjata, sidomos në kushte pandemie. Ky revolucion ka sjellë thjeshtësim të procedurave, standartizim të aplikimeve, eliminim të një sërë dokumenteve, por edhe shërbim më të mirë e më të shpejtë. Në periudhën 2020-2022 janë kryer në total 538,749 aplikime nëpërmjet platformës e-albania. I gjithë ky proces i rëndësishëm është bërë i mundur nëpërmjet ndërveprimit të vazhdueshëm midis institucioneve, rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit të qytetarëve, monitorimit efikas të të gjithë proceseve, si dhe rritjes së mëtejshme të transparencës. Një rol të rëndësishëm në zbatimin e kësaj reforme madhore kanë edhe burimet njerëzore, që çdo ditë aftësohen për të garantuar ecurinë e procesit dhe me profesionalizëm trajtojnë e zgjidhin çdo problematikë që mund të lindë..

### **Objektivi i politikës**

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

1. Krijimi i lehtësirave për një kategori personash me profesion në fushën e teknologjisë së informacionit, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në një fushë specifike sikurse janë Tekno-Parqet, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi me elemente të sigurimeve shoqërore nxit punësimin dhe investimet;
2. Përjashtimin, brenda vitit 2024, nga barra e pagesës së kontributeve të një kategorie përfituesish të pensionit të pleqërisë që vetëpunësohen si të vetëm në sektorin privat;
3. Garantimin e harmonizimit të kuadrit ligjor të zbatueshëm në këtë fushë brenda vitit 2024.
4. Shmangien e barrës administrative nëpërmjet dixhitalizimit të procesit të aplikimeve për përfitimin e pensioneve të pleqërisë;
5. Garantimi i rikuperimit brenda vitit 2024, të 80% të kësteve të pensioneve të derdhura tepër në llogarinë e pensionistit pas vdekjes.

### **Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara**

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

#### *OPSIONI 0 (status quo-ja)*

Avantazh: Nuk ka efekte financiare për qeverinë.

Dizavantazh: Mosndërrhyrja e qeverisë nëpërmjet një politikë të caktuar do të bënte të pamundur arritjen e objektivave.

Ky opsion nënkupton mosndërrmarrjen e një nisme në fushën e sigurimeve shoqërore. Mosndërrhyrja e qeverisë nëpërmjet një mekanizmi rregullator apo jo rregullator, për të ndryshuar/modifikuar qasjen e ndjekur deri më tani, shoqërohet me avantazhet dhe disavantazhet e saj.

Ndër avantazhet mund të rendisim mosekzistencën e efekteve financiare negative, direkte, për buxhetin e shtetit. Nëse zgjidhet ky opsion, nuk do të krijohet një grup pune përgjegjës për të përgatitur nismën rregullatore apo për të konceptuar ndërhyrjen jo rregullatore. Njëkohësisht shteti do të mund të “ruajë” të ardhurat që aktualisht mbledh në kuadër të pagesës së kontributeve shoqërore nga pensionistët e vetëpunësuar si të vetëm.

Megjithatë, nëse zgjidhet opsioni 0, disavantazhet ekonomike, rregullatore dhe sociale, direkte apo indirekte, afatshkurtra, apo me afatgjata, do të tejkalojnë avantazhet e këtij opsioni.

Zgjedhja e opsionit të status quo-së nënkupton më konkretisht:

- Moszgjidhjen e problemit që buron nga ekzistenca e një kuadri rregullator të paharmonizuar;
- Moskrijimin e lehtësirave fiskale për zhvilluesit, përdoruesit dhe të punësuarit IT në parqet teknologjike/shkencore, në kuadër të ligjit përkatës. Kjo do të shoqërohet me efekte negative ekonomike në afatgjata për shkak të mos thithjes së investimeve në këtë fushë dhe moszhvillimit të këtyre parqeve sikurse është qëllimi i ligjit;
- Moszgjidhjen e problemit të pagesës së kontributeve shoqërore dhe për pensionistët që kanë ndërruar jetë.
- Vijimin e burokracive administrative për procedurat e aplikimit për marrjen e pensioneve, në mospërputhje me politikën e dixhitalizimit të proceseve administrative.

Për arsyet e lartpërmendura, gjykojmë se opsioni 0 nuk mund të zgjidhet si opsion i preferuar dhe duhet të vijohet me marrjen në konsideratë të opsioneve të tjera rregullatore.

#### *Opsioni 1 (i preferuar):*

Hartimi dhe miratimi i një projektligji për ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”

Ligji aktual rregullon dhe trajton efektivisht pjesën më të madhe të çështjeve që lidhen me sigurimet shoqërore, megjithatë Ministria e Financave dhe Ekonomisë së bashku me Institutin e Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet këtij projektligji kërkon të trajtojë/zgjidhë problematikat e hasura në punën e përditshme.

Ky opsion siguron realizmin e objektivave në një kohë më të shkurtër, pasi ndryshimet e propozuara prekin 9 nene nga 100 nene të ligjit aktual dhe për këtë arsye, në kuadër të teknikës legjislative, vlerësohet më e arsyeshme ndërhyrja nëpërmjet një ligji ndryshues dhe jo hartimit të një ligji të ri. Gjithashtu, nëpërmjet këtij opsioni adresohen në mënyrë shteruese problematikat e hasura në përditshmëri dhe të evidentuara në rubrikën përkatëse;

Në lidhje me analizën e kostove dhe përfitimeve që parashikohet të sjellë ky projektligj, kemi vlerësuar si metodë më të përshtatshme për të analizuar opsionet metodën e analizës me shumë kritere. Kuantifikimi i kostove dhe përfitimeve nga ndryshimet e parashikuara në këtë projektligj në vlerë monetare rezultoi i pjesshëm dhe i vështirë për t’u bërë.

**Ndryshimi i ligjit ekzistues Nr. 7703/1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, është vlerësuar me më shumë pikë, për këtë arsye është përzgjedhur si opsion i preferuar.**

Megjithatë sqaroj se: Efektet financiare për lehtësirat që do të përfitojnë personat e punësuar në fushën e teknologjisë së informacionit (IT) që janë të regjistruar në subjektet me aktivitet kryesor në fushën e teknologjisë së informacionit, të cilët do të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore në nivelin e pagës minimale mujore në shkallë vendi, pavarësisht pagës bruto të deklaruar nuk është i matshëm sepse maturimi i saj është afatgjatë.

Efektet financiare për nismën e Këshillimit Kombëtar është: Aktualisht janë 1 484 përfitues të pensionit të pleqërisë të vetëpunësuar të vetëm në sektorin privat të cilët paguajnë kontribute çdo muaj në masën 14,151,424 lekë, të cilat kalojnë në fondin e sigurimeve shoqërore. Shuma 169,817,088 lekë në vit me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve do të zbritet nga të ardhurat në fondin e sigurimeve shoqërore.

#### *Opsioni 2: “Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri”*

Përderisa ligji ekzistues është i vitit 1993 dhe ka pësuar ndryshime ndër vite, është marrë në konsideratë edhe opsioni i miratimit të një ligji të ri që do të mund të konsolidonte legjislacionin dhe do të bënte të mundur realizmin e objektivave. Megjithatë, nisur dhe nga konteksti aktual, nevoja e ndërhyrjes në një kohë sa më të shkurtër dhe faktit që ndryshimet nuk prekin më shumë se 50% të dispozitave të ligjit në fuqi, është vendosur të mos zgjidhet si i preferuar ky opsion pasi kërkon më shumë kohë dhe resurse (njerëzore dhe financiare) për tu zbatuar.

#### **Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve**

- *Identifikoni grupet e prekura.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*

- *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
- *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
- *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
  - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
  - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
  - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
  - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbliidhni vlerësimin e opsioneve:*
  - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
  - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
  - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Grupet e prekura nga opsioni i preferuar janë:

1. Qeveria;
2. Zhvilluesit, përdoruesit e parqeve teknologjike/shkencore;
3. Punonjësit IT, të punësuar në parqet teknologjike/shkencore, sipas ligjit 58/2022;
4. Pensionistët e vetëpunësuar, si të vetëm;
5. Familjarët/trashëgimtarët e pensionistëve që kanë ndërruar jetë;
6. Qytetarët.

### **Ndikimet ekonomike:**

- **Direkte**
  - **Pozitive**

*Për qeverinë (Buxhetin e Shtetit):*

Zbatimi i opsionit të preferuar do të mundësonte rikuperimin brenda një kohe sa më të shkurtër të pagesave të pensioneve të hedhura tepër (pas kohës së vdekjes), për pensionistët që kanë ndërruar jetë. Aktualisht ky problem është evidentuar kryesisht për pensionistët që jetojnë jashtë vendit, por shumat gjithsesi janë të konsiderueshme dhe me zbatimin e këtij opsioni synohet rikuperimi dhe rikthimi në fondin e sigurimeve shoqërore të 80% të fondeve të bllokuara. Gjatë vitit 2022 ka patur 78 përfitues që kanë ndërruar jetë për shkak të mos çregjistrimit në kohë nga gjendja civile duke iu gjeneruar në llogaritë personale bankare këstet e tepërta të përfitimit pas muajit të vdekjes, në një shumë prej 1,642,717 lekë të cilat rezultojnë të pakthyera në fondin e sigurimeve shoqërore. Në kuadër të lëvizjes së lirë të shtetasve është e pamundur të parashikohet se sa do të jetë numri i pensionistëve që do të ndërrojnë jetë jashtë vendit dhe që nuk arrijnë për arsye të ndryshme të shpallen të vdekur në regjistrin e gjendjes civile, megjithatë kjo ndërhyrje rregullatore do të shërbejë për zgjidhjen e tyre brenda një kohe të shkurtër.



*Për zhvilluesit, përdoruesit e parqeve teknologjike/shkencore:*

Zbatimi i opsionit të preferuar ka një efekt të pritshëm pozitiv tek zhvilluesit dhe përdoruesit e parqeve teknologjike/shkencore, duke qenë se politika mundëson një mekanizëm lehtësues për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore për personat e punësuar në fushën e teknologjisë së informacionit (IT) sipas Ligjit Nr. 58/2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Parqeve Teknologjike dhe Shkencore”. Ky mekanizëm përjashton derdhjen e kontributeve shoqërore sipas skemës aktuale dhe mundëson derdhjen e kontributeve nga zhvilluesit/përdoruesit (punëdhënësi) duke marrë si bazë pagën minimale në shkallë vendi, vetëm për këtë kategori të punësuarish. Pra, ky është një ndikim pozitiv ekonomik për zhvilluesit/përdoruesit e parqeve. Megjithatë është e pamundur të parashikohet sa të punësuar në fushën e IT mund të ketë në të ardhmen në këto parqe teknologjike/shkencore për arsye objektive, pas ndërmarrjes së politikës në fjalë. Rrjedhimisht është i pamundur objektivisht kuantifikimi I efektit të pritshëm në financat e këtyre bizneseve.

*Për pensionistët e vetëpunësuar, si të vetëm:*

Kjo politikë do të impaktojë pozitivisht të gjithë pensionistët e punësuar si të vetëm në sektorin privat, duke qenë se do të përjashtohen nga detyrimi për pagimin e kontributeve shoqërore në vijim, pasi ata kanë plotësuar tashmë kushtet për përfitimin e pensionit të pleqërisë. Ky opsion prek 1 484 pensionistë të vetëpunësuar dhe ofron lehtësim për aktivitetet që gjenerojnë të ardhura minimale siç janë aktiviteti ekonomik që zhvillojnë personat fizik të vetëpunësuar të vetëm. Çdo pensionist i vetëpunësuar si i vetëm, në sektorin privat, kontributin e sigurimeve shoqërore tashmë do ta ketë si të ardhur të shtuar në buxhetin personal apo të biznesit.

*Për punonjësit IT, të punësuar në parqet teknologjike/shkencore, sipas ligjit 58/2022:*

Zbatimi i opsionit të preferuar ka një efekt të pritshëm pozitiv tek punonjësit IT, të punësuar në parqet teknologjike/shkencore, duke qenë se politika mundëson një mekanizëm lehtësues për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore për personat e punësuar në fushën e teknologjisë së informacionit (IT) sipas Ligjit Nr. 58/2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Parqeve Teknologjike dhe Shkencore”. Derdhja e kontributeve shoqërore për këtë kategori të punësuarish, tashmë do të kryhet mbi bazën e pagës minimale dhe duke qenë se një pjesë e kontributeve bazuar në skemën aktuale paguhet nga punonjësit, kjo do të ketë ndikim në financat e këtyre punonjësve pasi do të shtohen në të ardhurat personale të tyre. Ashtu sikurse është thënë dhe më lart, aktualisht është e pamundur të parashikohet sa të punësuar në fushën e IT mund të ketë në të ardhmen në këto parqe teknologjike/shkencore për arsye objektive, pas ndërmarrjes së politikës në fjalë.

*Për qytetarët:*

*Duke qenë se, aktualisht ofrohen 56 shërbimeve online dhe harmonizimi i ligjit aktual do të mundësojë vijimin e dixhitalizimit të këtyre shërbimeve, kjo do të ketë një impakt pozitiv për qytetarët duke qenë se mundëson:*

Ulje të barrës administrative;

Ulja të kostove për disponimin e një dokumenti administrativ;

Reduktimin e kohës për disponimin e dokumentit administrativ.

- **Direkte**

- **Negative**

Ndryshimet e politikës lidhur me vendosjen e pagës minimale si bazë për pagesën e kontributeve nga punonjësit IT, të punësuar në parqet teknologjike/shkencore, sipas ligjit 58/2022, si dhe përjashtimi nga pagesa e kontributeve të pensionistëve të vetëpunësuar të vetëm sjellë reduktim të të ardhurave në fondin e sigurimeve shoqërore, në buxhetin e shtetit.

Aktualisht janë 1 484 përfitues të pensionit të pleqërisë të vetëpunësuar të vetëm në sektorin privat të cilët paguajnë kontribute çdo muaj në masën 14,151,424 lekë, të cilat kalojnë në fondin e sigurimeve shoqërore. Shuma 169,817,088 lekë në vit me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve do të zbritet nga të ardhurat në fondin e sigurimeve shoqërore.

Sa i takon, të punësuarve në fushën IT, në parqe teknologjike/shkencore, është e pamundur të parashikohet numri i tyre në të ardhmen në këto parqe teknologjike/shkencore dhe rrjedhimisht është objektivisht i pamundur edhe kuantifikimi i efektit të pritshëm në buxhetin e shtetit.

Megjithatë, reduktimi i të ardhurave në buxhetin e shtetit, si pasoje e ndërmarrjes së kësaj politike justifikohet plotësisht për arsyet si më poshtë vijon:

- Do të ketë një zhvillim të aktivitetit të ndërmarrjeve inovative, siç janë parqet teknologjike/shkencore;
- Rritje të numrit të të punësuarve në parqet teknologjike/shkencore;
- Rritje e nivelit të investimeve në këtë kategori biznesi që përkthehet në rritje të nivelit ekonomik të vendit;
- Zhvillim i aktivitetit ekonomik që gjeneron të ardhura minimale dhe që zhvillohen nga personat fizik, pensionistë, të vetëpunësuar, si të vetëm.

### **Ndikimet sociale:**

- **Direkte**

#### **Pozitive**

*Për qytetarët:*

*Sa i takon ndikimeve sociale që zbatimi i opsionit 1 pritet të ketë, mund të rendisim:*

- Rritja e besimit të qytetarëve kundrejt qeverisjes elektronike;
- Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve dhe kryesisht pensionistëve;
- Ulja e barrës administrative nëpërmjet ofrimit të shërbimeve elektronike 24 orë në 7 ditë të javës;
- Reduktimi i kohës për disponimin e dokumentit administrativ;
- Shtimi dhe përmirësimi i shërbimeve elektronike për publikun;
- Trajtimi në kohë, me eficiencë dhe drejtësi të kategorive specifike duke thjeshtëzuar procedurat e përfitimeve nga ligji;
- Rritja e numrit të përdoruesve të e-shërbimeve;
- Ndhomon dhe nxit në zhvillimin e politikave të reja të punësimit;

### **Arsyetimi i opsionit të preferuar**

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është përzgjedhur opsioni 1 - Kryerja e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 ‘Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar’, pasi nëpërmjet këtij opsioni mund të sigurohet zhvillimi i mëtejshëm i aktivitetit të parqeve teknologjike/shkencore që zhvillojnë aktivitetin sipas Ligjit Nr. 58/2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Parqeve Teknologjike dhe Shkencore”, realizmi i objektivave të vendosura në një kohë më të shkurtër, pasi

ndryshimet e propozuara prekin vetëm 9 nene nga 100 nene të ligjit aktual dhe në kuadër të teknikës legislative, nuk vlerësohet si i arsyeshëm hartimi i një ligji të ri.

- Adreson në mënyrë shteruese problematikat e hasura në përditshmëri;
- Harmonizon ligjin aktual me legjislacionin në fuqi për ofrimin e shërbimeve elektronike (Ligji Nr.107/2021 “Për bashkëqeverisjen” si dhe VKM Nr. 252, datë 29.4.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”).

Për të dhënë një ide më të qartë të arsyeve së përzgjedhjes së Opsionit 1 si opsioni i preferuar për implementimin e politikës, është përgatitur analiza multikritere.

### **Opsionet që merren në konsideratë për analizën me shumë kritere janë:**

*Opsioni 0* – Ruajtja e status quo-së, të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues;

*Opsioni 1* – (i preferuar) *rregullator- Kryerja e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 ‘Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar’*;

*Opsioni 2:* “Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri”.

Për të vlerësuar opsionet duke përdorur analizën me shumë kritere, janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

Janë përcaktuar kriteret që tregojnë arritjen e objektivave dhe është vendosur pesha e kriterëve sipas rëndësisë relative:

1. Krijimi i kushteve të favorshme dhe efikase për punësimin e profesionistëve në fushën e TI, që do të punësohen në parqet teknologjike/shkencore.;
2. Efikasiteti në krijimin e mekanizmave për sigurimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve elektronike (të ISSH) 24 orë në 24, 7 ditë të javës;
3. Efikasiteti në krijimin e një mekanizmi ligjor që përjashton nga barra e pagesës së kontributeve të një kategorie përfituesish të pensionit të pleqërisë që vetëpunësohen si të vetëm në sektorin privat;
4. Efikasiteti në krijimin e mekanizmave ligjorë për pagesat e bllokuara, në llogarinë e pensionistit, që nuk mund të kthehen në llogaritë e fondit me kërkesë zyrtare të organeve të Sigurimeve Shoqërore ;
5. Kosto - Efektiviteti.

Pra, për të bërë dallimin e opsioneve nga njëra-tjetra dhe me qëllim përzgjedhjen e opsionit më të mirë secili kriter është vlerësuar me një peshë specifike vlerësuar nga 1-5;

Gjithashtu, secili kriter në varësi të peshës së tij, është vlerësuar me pikë përkatëse sipas shkallës së preferencës për çdo opsion për secilin kriter nga 0-5 ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Matrica e performancës:

<b>Kriteret</b>	<b>Pesha</b>	<b>Opsioni 0</b>	<b>Opsioni 1</b>	<b>Opsioni 2</b>
Krijimi i kushteve të favorshme dhe efikase për punësimin e profesionistëve në fushën e TI, që do të punësohen në parqet teknologjike/shkencore.	4	0 (0)	4 (16)	4 (16)
Efikasiteti në krijimin e mekanizmave për sigurimin e vazhdimësisë së ofrimit të	3	1 (3)	3 (9)	3 (9)

shërbimeve elektronike (të ISSH) 24 orë në 24, 7 ditë të javës				
Efikasiteti në krijimin e një mekanizmai ligjor që përjashton nga barra e pagesës së kontributeve të një kategorie përfituesish të pensionit të pleqërisë që vetëpunësohen si të vetëm në sektorin privat.	4	0 (0)	4 (16)	4 (16)
Efikasiteti në krijimin e mekanizimeve ligjorë për pagesat e bllokuara, në llogarinë e pensionistit, që nuk mund të kthehen në llogaritë e fondit me kërkesë zyrtare të organeve të Sigurimeve Shoqërore.	3	1 (3)	3 (9)	3 (9)
Kosto - Efektiviteti	5	1 (5)	5 (25)	2 (10)
<b>Pikët</b>		<b>11</b>	<b>75</b>	<b>60</b>

*Sikurse rezulton nga analiza opsioni i preferuar rezulton opsioni 1 i cila ka dhe numrin më të lartë të pikëve me 75 krahasuar me opsionin 2 dhe opsionin 0.*

*Si rezultat, vlerësojmë që opsioni më i përshtatshëm dhe nga pikëpamja financiare do të jetë opsioni i ndryshimeve në ligjin ekzistues.*

### **Çështje të zbatimit**

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e opsionit të preferuar do të jenë Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të jetë struktura përgjegjëse për administrimin e sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe i politikave të pensioneve në veçanti si dhe për përmirësimin e shërbimit ndaj tyre.

ISSH do të jetë përgjegjëse për:

- garantimin e mbulimit të *punonjësve IT, të punësuar në parqet teknologjike/shkencore, sipas ligjit nr. 58/2022* me elementë të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, bazuar në një skemë lehtësuese të derdhjes së kontributeve për këtë kategori;
- përjashtimin nga skema e kontributeve shoqërore të pensionistëve të vetëpunësuar në sektorin privat, si të vetëm;
- evidentimin dhe rikuperimin brenda një kohe sa më të shkurtër të pagesave të pensioneve të hedhura tepër (pas kohës së vdekjes), për pensionistët që kanë ndërruar jetë;
- ofrimin efektiv të shërbimeve elektronike që mbulojnë nga institucion kundrejt qytetarëve, 24 orë në 7 ditë të javës.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të jetë përgjegjëse për dërgimin e informacionit pranë ISSH mbi:

- numrin e personave të regjistruar si punonjës *IT, të punësuar në parqet teknologjike/shkencore, sipas ligjit 58/2022*, si dhe lidhur me kategorinë e punësimit;
- numrin e pensionistëve të vetëpunësuar në sektorin privat si të vetëm.

Një pengesë e mundshme, sa i takon në përgjithësi çështjes së derdhjes së kontributeve shoqërore në llogari të pensionistëve që nuk jetojnë më, është edhe fakti që raste të tilla nuk janë të lehta për t'u evidentuar në

kohë lidhur dhe me faktin kur këto persona kanë jetuar jashtë vendit. Në lidhje me këtë pengesë duhet theksuar se, eliminimi i plotë i këtyre rasteve është praktikisht i pamundur. Nëse personi ka jetuar brenda vendit, evidentimi i rastit mund të bëhet në kohë më të shpejtë falë edhe bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, por problematike mbeten rastet kur personi ka jetuar jashtë vendit për shkak të mos ekzistencës të këtij lloj bashkëpunimi, ose të vonesave që mund të ketë edhe nëse bashkëpunimi me autoritetet e vendit të huaj ekziston.

Një pengesë tjetër mund të jetë edhe, abuzimi i zhvilluesve/përdoruesve të parqeve teknologjike/shkencore në deklarin e rremë të kategorisë së të punësuarve (si IT), ndërkohë që mund të punojnë praktikisht në profesione të tjera, me qëllim derdhjen e kontributeve mbi bazë të pagës minimale në shkallë vendi. Kjo pengesë mund të shmanget, nëpërmjet inspektimeve të vazhdueshme nga insitucionet përgjegjëse (DPT, MFE si insitucion përgjegjës për monitorimin e parqeve, inspektorati i punës, etj) dhe konstatimit të rasteve të tilla abuzuese, me qëllim shmangien e tyre në vazhdim.

### **Faza e monitorimit dhe vlerësimit**

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit, aftësimit profesional dhe sigurimeve shoqërore, e cila mbështet funksionimin efektiv të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, do të jetë struktura përgjegjëse për monitorimin e arritjeve të treguesve pas miratimit të politikës.

MFE do të monitorojë arritjen e treguesve nëpërmjet mbledhjes dhe analizimit të raportimeve periodike të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e politikës (ISSH dhe DPT).

ISSH kryen raportime të vazhdueshme periodike monitorimi dhe auditimi, kryen raportimin e statistikave vjetore për tregues të përgjithshëm, si dhe harton Raportin Vjetor të ISSH. Në këto raporte evidentohet ndër të tjera edhe numri i shërbimeve të ofruara nga ISSH, numri i dokumentave të aksesuara nga publiku, numri i pensionistëve të vetëpunësuar në sektorin privat si të vetëm, etj.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve monitorohet nga MFE nëpërmjet raporteve periodike të monitorimit dhe raporteve vjetore.

Gjithashtu, pranë MFE funksionon një njësi speciale për monitorimin e parqeve teknologjike dhe shkencore, e cila monitoron me detaje ecurinë ekonomike dhe zbatimin e planit të biznesit lidhur me keto të fundit, e cila në përfundim të monitorimit harton raportin përkatës, të cilin ja paraqet ministrit përgjegjës për financat dhe ekonominë.

Disa prej *kritereve/treguesve që do të shërbejnë për të matur arritjen e objektivave janë:*

- Numri i pensionistëve të vetëpunësuar në sektorin privat si të vetëm;
- Numri i personave të punësuar si IT, në parqet teknologjike/shkencore;
- Numri i pagesave të pensioneve të rikuperuara, të cilat janë hedhur tepër;
- Numri i shërbimeve të ofruara nga ISSH për një periudhë 1 vjeçare;
- Numri i dokumentave të aksesuara nga publiku për një periudhë 1 vjeçare.

## Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

*Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.*

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
<b>Faktori zbritës</b>		<b>0.95</b>	<b>0.90</b>	<b>0.86</b>	<b>0.82</b>	<b>0.78</b>	<b>0.74</b>	<b>0.71</b>	<b>0.67</b>	<b>0.647</b>
		<b>2834</b>	<b>7893</b>	<b>282</b>	<b>4271</b>	<b>5394</b>	<b>8350</b>	<b>3054</b>	<b>9423</b>	<b>3781</b>
	<b>1</b>	<b>683</b>	<b>933</b>	<b>8</b>	<b>394</b>	<b>373</b>	<b>999</b>	<b>787</b>	<b>332</b>	<b>15</b>
Kosto për buxhetin – njëherë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
<b>Kosto në total</b>										
<b>Kosto e zbritur në total</b> = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										

Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
<b>Përfitimi në total</b>										
<b>Përfitimi i zbritur në total</b> = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
<b>Vlera aktuale e kostos në total</b>										
<b>Vlera aktuale e përfitimit në total</b>										
<b>Vlera aktuale neto (VAN)</b> =Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

## Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

*Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni*

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	0	0	0

**MINISTËR**

[Emri Mbiemri]